



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada – Government*  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

## THIRRJE PËR PROJEKT-IDE PËR INVESTIME KAPITALE

MOTO E KËSAJ THIRRJE

*'TË MOS E LËMË ASKEND PAS'*

Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

Programi për Zhvillim Rajonal  
**THIRRJE PËR PROJEKT-IDE  
PËR INVESTIME KAPITALE**  
me fokus në:

- TURIZËM NATYROR
- TURIZËM KULTUROR
- TURIZËM SPORTIV
- TURIZËM SHËNDETËSOR
- INFRASTRUKTURË PUBLIKE PËRCJELLËSE

\* Thirrja është e hapur për 38 komunat  
Për më shumë detaje, referohuni tek vepra në vijim:  
<https://mzhr.rika.gov.net/page.aspx?id=136>

Sesione të informacione dhe punëtoritë para-përgatitore do të organizohen nga MZHR në partneritet me Programin për Zhvillim Gjithëpërfshirës të zbatuar nga UN-Habitat Kosova dhe financuar nga Sverige

## QËLLIMI

Ministria për Zhvillim Rajonal përmes Programit për Zhvillimin Rajonal, dhe me qëllim të përmbushjes së objektivave të Strategjisë për Zhvillim Rajonal si dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Agjenda 2030), fton të gjitha komunat e Kosovës ti përgjigjen thirrjes përmes projekt-ideve kreative të bazuara në karakteristikat, potencialet natyrore/kulturore dhe prioritetet e rajoneve përkatëse, të cilat synojnë zbutjen e pabarazive dhe nxitjen e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm social dhe ekonomik brenda rajoneve zhvillimore.

## OBJEKTIVAT KRYESORE:

- Mbështetja e projekt-ideve të dizajnuara përmes qasjes së integruar dhe gjithëpërfshirëse, dhe të cilat janë në harmoni me objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal dhe strategjitë tjera lokale dhe nacionale.
- Rritja e potencialit ekonomik dhe turistik, si dhe ndjeshmërisë mjedisore në të gjitha komunat, respektivisht rajonet e Kosovës përmes projekteve që ndërlidhin aspektet turistike, sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore.

## OBJEKTIVI SPECIFIK:

- Përkrahja e komunave me grante për identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e projekt-ideve që bazohen në karakteristikat dhe potencialet e vendit/rajonit, dhe që ndërlidhen me zhvillimin e potencialeve të turizmit natyror, kulturor, sportiv dhe shëndetësor, përmes ndërhyrjeve konkrete dhe vizive në zonat urbane dhe rurale.

## DISA SHEMBUJ PËR INSPIRIM:

- **Turizëm Natyror:** parqe të aventurave, shtigje për ecje, shtigje natyrore, shtigje për alpinizëm, ballkone panoramike, ura (druri, guri, etj.), etj.
- **Turizëm Kulturor:** restaurimi/rehabilitim i objekteve të trashëgimisë kulturore; rehabilitim i lagjeve të vjetëra, rindërtimi/rehabilitimi i qendrave historike të qyteti, ndërtim i muzeve specifike për rajonin (që ndërthurin modernen me të vjetrën, elemente specifike të rajonit) përmes përdorimit të materialeve adekuate (panele solare, metoda që reduktojnë shpenzimet në energji, ripërodrim të ujërave atmosferik përmes dizajnit adekuat të hapësirave, etj.).
- **Turizëm Sportiv:** fusha sportive, objekte sportive, mure (atraksione turistike) për ngjitje, platforma fluturimi (me parashuta, etj.).
- **Turizëm Shëndetësor:** ndërtimi i qendrave rehabilituese në natyrë (për personat me varësi të ndryshme, ose qendra tjera me karakter të ngjashëm).
- **Infrastrukturë përcjellëse:** shtigje, ndriqim, stacione, vendprijtje etj.

## REZULTATET E PRITSHME AFATSHKURTËRA:

- Kapacitete të fuqizuara komunale për identifikimin, zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e projekteve kapitale

- Projekte të identifikuar dhe zhvilluar bashkarisht me komunitetin dhe palët relevante të interesit (përfshirë OJQ-të, etj.)
- Projektet të bazuara në karakteristikat dhe potencialet vendore, por që kanë ndikim pozitiv socio-ekonomik në rajone të caktuara
- Projektet që rrisin kohezionin social por edhe promovojnë dhe mbrojnë asetet natyrore dhe kulturore të rajoneve
- Projekte të identifikuar dhe zhvilluar nga dy ose më shumë komuna përmes bashkë-financimit (preferohen dhe inkurajohen)
- Pronësi më e madhe mbi projektet e realizuara nga autoritetet publike, komuniteti, shoqëria civile, palët e interesit, etj.
- Gadishmëri politike dhe teknike e shprehur përmes planifikimeve buxhetore adekuate si dhe proceseve të hapura dhe transparente

#### REZULTATET E PRITSHME AFATGJATE:

- Autoritet publike (komunale) të përgaditura në menaxhimin e suksesshëm të gjithë ciklit të projekteve të investimeve kapitale
- Shkallë më e lartë e gjithëpërfshirjes dhe transparencës gjatë identifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të ciklit të projekteve
- Përmirësim i kualitetit të jetesës së qytetarëve në zonat, rajonet e caktuara
- Më pak pabarazi në mes të rajoneve në Kosovë

#### INFORMATA SHITESË:

Për të përkrahur aplikuesit me informatat e nevojshme dhe përvojën e partnerëve në identifikimin/ përzgjedhjen e projekteve, Ministria për Zhvillim Rajonal në partneritet me UN-Habitat-in Kosovë dhe me financim nga Qeveria Suedeze do të organizojë 2 punëtori parapërgaditore (sesione informuese) me përfaqësuesit e komunave dhe OShC-ve. Datat dhe ftesat do të publikohen në ndërkohë.

Adresat në vijim do të shërbejnë për çdo pyetje apo paqartësi: [Jeta.Nushi@rks-gov.net](mailto:Jeta.Nushi@rks-gov.net)

Projekt propozimet duhet të përmbushin **kriteret** e vendosura në **“Udhëzuesin për Aplikantë”** dhe duhet të përshkruhen në **formën e projekt propozimit (Shtojca 1)**. Për rastet e projekt propozimit të përbashkët të **dy apo më shumë komunave, komunat duhet të plotësojnë formën e projekt propozimit (Shtojca 2)**. E gjithë paketa për aplikim mundë të shkarkohet në vegzën në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,36>

Ju lutem keni parasysh se **afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve është 2 shtator 2022, ora 16:00**. Paketa e projekt propozimit dërgohet përmes e mail-it: [Jeta.Nushi@rks-gov.net](mailto:Jeta.Nushi@rks-gov.net)

#### HAPAT E ARDHSHEM:

1. Dorëzimi i projekt propozimin tuaj në MZHR (jo me vonë se 2 shtator 2022, ora 16:00)

2. Vlerësimi i projekt propozimeve nga paneli i MZHR. Sipas nevojës, do kërkohen sqarime/plotësime shtesë rreth projekt-propozimit (shtator 2022)
3. Nëse ideja e projektit tuaj përzgjidhet, MZHR do të miratojë zhvillimin e mëtutjeshëm dhe finalizimin detal të projekt propozimit. Rekomandimet potenciale duhet patjetër të përfshihen;
4. Projekt propozimi para-final duhet ti prezantohet para panelit vlerësues të MZHR-së. Rekomandimet përfundimtare do të jepen
5. Njoftimi i komunave mbi rezultatin përfundimtar (shtator 2022)
6. Përgaditja dhe nënshkrimi i Memorandume të Mirëkuptimit me komunat fituese (shtator 2022)
7. Përgaditja e PIP, miratimi i projekteve në Qeveri dhe zotimi i mjeteve (janar-shkurt 2023)
8. Përgaditja e dokumentacionit, tenderimit dhe zbatimi i projektit, përfshirë planin e vizibilitetit në medime sociale (shkurt-dhjetor 2023)
9. Përgaditja dhe doërzimi i raporti final (janar 2024)